



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 9480 prot.

Ballsh më, 01.09.2026

VENDIM

Nr. 47 Datë 28/08 / 2026

“PËR

**MIRATIMIN E PROJEKTIT ME OBJEKT: RIKONSTRUKSIONI I RRUGËVE NË
NJËSINË ADMINISTRATIVE FRATAR, BASHKIA MALLAKASTËR”**

Mbështetur në nenin 9, pika 1.2, shkronja “b”, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin Nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen e në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, VKB-së nr.52, datë 23.12.2025 “Për miratimin e financimeve të ndarë në 3-vite” si dhe projektit të hartuar nga ana e Bashkisë Mallakastër,

PROPOZOJ

I. Miratimin e projektit “Rikonstruksioni i rrugëve në Njësinë Administrative Fratar, Bashkia Mallakastër, me nën segmentet si më poshtë

- 1.1. Rruga Bejar - Zaimaj
- 1.2. Rruga Ninësh – Shkëmbi i Koçit

II. Miratimin në parim për shpronësimin / zhdëmtimin e pronave që mund të preken nga zbatimi i projektit.

III. Ky vendim shoqërohet me relacion shpjegues.

IV. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6 e Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”

KRYETAR

Nexhmi Sulaj

